



REPUBLIKA E KOSOVËS



KOMUNA E ISTOGUT

KONTRATË PËR PUNË

KOMUNA E ISTOGUT në vazhdim "*Njësia e Prokurimit*", të cilën e përfaqëson znj, *Zizë Bujupaj*, menaxhere e Prokurimit, Rruga "*Fadil Ferati*" Nr. 121 në njërën anë;

Dhe

NN "KABASHI" , Komuna e Istogut, të cilën e përfaqëson z. *Sali Kabashi*, me Nr. Rexh. Biznesi, 70223364 (në vazhdim "*Kontraktuesit*"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për punë e shënuara me poshtë:

TITULLI I KONTRATËS:

**NDERTIMI DHE RREGULLIMI I RRUGËVE DHE I TROTUAREVE
NE ISTOG**

<i>Nr. I prokurimit</i>	633-18-7251-5-2-1/ C168 Lot 2
<i>Nr. I brendshëm</i>	633 / 018 / 051/ 521

Neni 1 Lënda:

1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i furnizimeve dhe punëve në vijim nga ana e Kontraktuesit:

**NDERTIMI DHE RREGULLIMI I RRUGËVE DHE I TROTUAREVE
NE ISTOG**

Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi total i punëve per aktivitetin e prokurimit

NDERTIMI DHE RREGULLIMI I RRUGËVE DHE I TROTUAREVE
NE ISTOG është 48.790,00 € dhe me fjalë:
/Katërdhjetetë mijë e shtatë çindeteen në dhjetë €

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve përgjatë ekzekutimit të kontratës.

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

*Marrëveshja e kontratës;
Kushtet e Veçanta të Kontratës;
Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet
Teknike;
Oferta financiare (Paramasa dhe Paralogaria);
Plani për menaxhimin e kontratës
Procesverbalet e Vizitës në teren e mbikqyesi*

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 4 Komunikimet

4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit

Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.



4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimi të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimi të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetohet", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

Për Autoritetin Kontraktues:

Për Kontraktuesin:

Emri:	Zizë Bujupaj	Emri:	Sali Kabashi
Pozita:	Zyrtar Përgjrgjës i Prokurimit	Pozita:	D r e j t o r
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	27. 11/2018	Data:	27/11/2018
Vu la		Vu la	

PJESA III E KONTRATES**kushtet e veçanta**

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	
Ligji zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë gjuha SHQIPE
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	7.2	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: sipas Ligjeve në fuqi që rregullojnë lemin e siguracioneve.
Programi	8.1	Kontraktuesi do ta dorëzojë për aprovim Programin për Punët brenda 2. ditëve nga data e Nënshkrimit të kontratës.
Siguria e ekzekutimit	10	Siguria e ekzekutimit të kontratës është 10% e vlerës së kontratës, në afat prej 90 ditëve
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të jetë 2. ditë pas nënshkrimit të kontratës, gjegjësisht me datë kur menaxheri i kontratës e përcakton në ditarin e punës dhe Librin ndertimor si dhe PLANIN PER MENAXHIM TË KONTRATËS.
Përfundimi i punimeve	17.2	Data e përfundimit për furnizimet dhe instalimet do të jetë: 60 ditë.
Dëmet likuiduara		Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë llogaritura për ditë dhe atë 0.25 % për ç'do ditë vonese të paarsyeshme.
	19.1	Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është 10 % e çmimit total të Kontratës.

Inspektimi dhe testimi	22.1	Zyrtari Kryesor Administrativ - Drejtorati perkates i inicimit te kerkeses do te caktoje nje zyrtar per implementim te kesaj kontrate.
Pagesat	24.1	Pagesat do te behen ne euro ashtu si raporton Organi Mbikqyrës, bazuar ne raportin e mbikqyrës, pas kryerjes së punimeve per situacionet përkatëse.
Përmirësimi i defekteve	31.1	Periudha garantuese e defekteve është 365 ditë, pas perfundimit te punimeve, bazuar ne deklaraten e kontraktorit.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.1	KOMISIONI RREGULLATIV I PROKURIMIT POUBLIK
	43.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykata Arbitrazhi - Odes Ekonomike te Kosovës